

Shpallur me 16.06.2021
Pozicioni me 012021



Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19 dhe 38/20), e në lidhje me nenin 5 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 043/20) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 09-032/21-7371 prej më 24.05.2021, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, shpall:

SHAPLLJE PUBLIKE

për nevojat e Sekretariatit për pronë të Komunës së Tuzit

1. Referent/e i/e pavarur për punë administrative teknike- sekretar/e teknik/e

- Ekzekutues: 1, në kohë të pacaktuar
- Niveli i IV1 i kualifikimit shkollor;
- së paku tre vite përvojë pune;
- provimi profesional për punë në organet shtetërore (mardhënien e punës mund ta lidh dhe personi pa provimin profesional për punë në organet shtetërore, me kusht që ta përfundojë atë brenda një viti nga dita e lidhjes së mardhënies së punës);
- njohja e gjuhës shqipe;
- njohja e punës në kompjuter.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit
- vërtetimin e gjyqit kompetent se kundër kandidatit /es nuk zhvillohet procedure penale sipas detyrës zyrtare,
- dëshmi (vërtetim/miratim) mbi përvojën e kërkuar të punës,
- vërtetim mbi provimin e dhënë profesional për punë në organet shtetërore (mardhënien e punës mund ta lidh dhe personi pa provimin profesional për punë në organet shtetërore, me kusht që ta përfundojë atë brenda një viti nga dita e lidhjes së mardhënies së punës).

Periodha e provës në punë është e obligueshme për zyrtarin shtetërorë i cili për herë të parë lidh marrëdhënie pune në kohëzgjatje të pacaktuar në organin shtetërorë. Periodha e provës zgjatë një vit.

Kandidatët mund tia dorëzojnë kopjen e dokumentacionit të lartpërmendur Zyrës për burimet njerëzore (Në tekstin e mëtejme, Zyrës), përderisa origjinalin janë të obliguar tia japin në shikim zyrtarit të autorizuar të Zyrës për realizimin e shpalljes.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili e ka realizuar të drejtën në paketën për shkurtim nga puna nuk mund të lidhin vendin e punës në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhën prej një viti nga dita e pagesës së paketës për shkurtim nga puna. Kufizimi nuk vlen për personin i cili e kthen shumën totale të paketës për shkurtimin e punës që ka pranuar.

Verifikimi i dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathësisë, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19 dhe 38/20). Lista e rregulloreve të nevojshme për procesin e verifikimit: Kushtetuta e Malit të Zi, Ligji mbi vetëqeverisjen lokale, Vendimi mbi organizimin dhe mënyrën e punës së Komunës së Tuzit, Rregullorja për funksionimin e zyrave, Ligji mbi punën, Ligji mbi zyrtarët dhe nëpunësit shtetëror.

Testimi në formë të shkruar përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike dhe nënkupton hartimin e testit të shkruar.

Verifikimi i dijes së daktilografisë, informatikës ose gjuhës së huaj bëhet në pajtim me rregullat, gjegjësisht standardet në këto fusha.

Testi i shkruar hartohet në formë elektronike, me shifër.

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore

Me shënim: për Shpallje publike për nevoja të Sekretariatit për pronë të Komunës së Tuzit

Kontakt tel: +38220875167;

**SEKRETARE,
Marina Ujkaj**

